

## **STATUT**

### **I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

#### **“Big Pharma” SH.P.K**

Në zbatim të ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” dhe ligjit në fuqi në Republikën e Shqipërisë, themeluesi:

Znj. Merita Muçaj, lindur në Beratmë 22.12.1983, dhe banuese në Tiranë, Rruga Eduard Mano, Nd 2, Hyrja 23, Apartamneti 27, Farkë, Selitë, 1044 Tiranë, shtetase Shqiptare, identifikuar me kartë identiteti nr.I36222056P, madhore e me zotësi të plotë Juridike për të vepruar.

Vendosi sot më datë 15.05.2023 për themelimin e kompanisë:

**“Big Pharma” SH.P.K.**

#### **KREU I**

**Emërtimi-Forma ligjore-Objekti  
Selia- Afati-Vula**

#### **Neni 1**

Shoqëria do te mbajëemrin **“Big Pharma” Shpk**, dhe emër tregtar **“Big Pharma” Sh.p.k**, me ortak të vetëm Znj. Merita Muçaj

Emërtimi i shoqërisë do të shfaqet në të gjitha aktet që do të dalin në emër dhe për llogari të shoqërisë.

#### **Neni 2 – Forma ligjore**

Kompania është një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar,në bazë të ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 “Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” shoqëria mund të konvertohet në një formë tjeter me vendim të themeluesve të saj.



### **Neni 3 - Objekti**

#### **Shoqëria ka si objekt të aktivitetit të saj:**

Tregti me shumice dhe pakice i materialeve, produkteve, pajisjeve, makinerive mjeksore, lazer kirurgikal dhe bukurie, pjese kembimi te pajisjeve mjekesore, produkte te ndryshme mjekesore, te konsumueshme Tregtim, import-eksport, i bimeve medicinale, i ilaçeve dhe i produkteve te gatshme dhe lendet se pare per kozmetiken. Mirembajtje makinerish spitalore, laboratorike, software te sektorit te mjeksise etj; Sherbime shendetesore; Sherbime mjeksore; Sherbime laboratorike; etj, Te marre pjese ne gara publike dhe private, shit-blerje, qeradhenie-keramarrje te tokes dhe ndertesave te cdo lloji, ndertim stendash panairesh, organizim panairesh, administrimin dhe menaxhimin e te gjitha llojeve te pasurive te patundshme dhe aktivitete te tjera lidhur me ndertimin e veprave industriale; organizimi, zbatimi dhe menaxhimi i eveneve, konventa, konferanca, kurse dhe shkolla te formimit profesional; studime dhe kerkime; zhvillimi, prodhimi dhe shperndarja ematerialeve arsimore: broshura, materiale audiovizuale, gazetave; Per te arritur objektin e kompanise, shoqeria mund te kryej te gjitha operacionet per pasurite e luajtshme dhe te paluajtshme dhe cdo veprimtari tjeter te nevojshme ose te dobishme, apo te kreditimit dhe dhenies me qira, te nje pjese te shoqerise qellimi i te cilit eshte e ngjashme ose i njejtë.

Tregtim me shumice te barnave per perdorim njerezor. Tregti me shumice dhe pakicë të materialeve, produkteve te kozmetikes, import, eksport te gjithe artikujve te kozmetikes. Servis per pajisje mjekesore, pjese kembimi te pajisjeve mjekesore. Shitje dhe blerje produktesh online ne e-comerc. Trajnine dermoestetike dhe trajnime te profesionisteve ne fushen e shendetesise.

### **Neni 4 - Selia**

Selialigjore e Shoqërisështë në, Tiranë, Rruga Eduard Mano,Nd 2, Hyrja 23,Apartamneti 8,Farke,Selite,1044 Tirane.

Asambleja e shoqërisë katë drejtë të hap seli të tjera dytësore, filiale, zyra përfaqësimi dhe seli prodhimi si në Shipëri ashtu edhe jashtë saj, madje të trasferojë Selinë e Shoqërisë, por kjo e fundit do të mbetet gjithësesi në territorin e Republikës së Shqipërisë.

### **Neni 5 - Kohëzgjatja e veprimtarisë**

Aktiviteti i Shoqerise do te fillojë ne daten e regjistrimit te tij ne QKB. Kohezgjatja e veprimtarisë së kesaj Shoqërije ështëme afat te papërcaktuar, por shoqëria mund të shpërbëhet në çdo moment me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

### **Neni 6-Vula**

Shoqeria do te kete vulen e saj me te drejte perdonimi nga administartori i saj. Forma e vules dhe madhesia e saj do te percaktohen nga ortaket themelues ne perputhje me kerkesat perkatese ligjore ne Shqiperi.

### **KREU II KAPITALI THEMELTAR DHE KUOTAT**

#### **Neni 7 -Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i Shoqërisë është 500,000 (peseqind e mijë) leke dhe mund të rritet në bazë të modaliteteve ligjore.

#### **Neni 8 – Vlera e kuotave dhe pjesëmarrja**

Kapitali themeltar i Shoqërisë përbëhet nga 1 (një) kuote, të mbajtuar nga ortaku i vetem i Shoqërisë:


Z. Merita Muçaj mbajtës i 1 (një) kuote, baraz me 100% të kapitalit me vlerë nominale prej 500.000 lek.

#### **Neni 9 – Trasferimi i kuotave**

Kuotat e kapitalit janë lirisht të trasferueshme, ne baze te legjislacionit te shoqerive Tregtare. Kuotat e kapitalit të shoqerise e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqerise;
- b) shitblerjes;
- c) trashegirnisë;
- ç) dhurirnit;
- d) çdo mënyre tjëter të parashikuar me ligj.

Pjeset e kapitalit themeltar janë lirisht te transferueshme, per sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.



## **Neni 10 – Zvogelimi apo rritja e kapitalit**

Ortaket mund te rrisin ose zvogelojne kontributet e tyre ne kapitalin themeltar vetem me vendim te ortakut te saj, ne masen e lejuar nga ligji, perndryshe kompania duhet te ndryshoj formen e vet ligjore.

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkimeve të pjesëve të kapitalit themeltar per kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë.

Zvogelimi i kapitalit lejohet vetem me vendim te Asamblese se Ortakeve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kerkohen per ndryshimin e statutit.

## **Neni 11- Financimet**

Financimet e bëra nga ortakët, në proporcione kuotat e mbajtura dhe në përputhje me vendimet e asamblesë, janë të lira nga interesat.

## **KREU III**

### **ASAMBLEJA, ADMINISTRATORI DHE EKSPERTI KONTABEL**

## **Neni 12 – Asambleja e Ortakëve dhe kompetencat e saj**

12.1 Organi vendimmarrës i Shoqërisë është Asambleja e Ortakëve.

12.2 Vendimet e Asamblesë së Shoqërisë për të cilat kërkohet një shumicë e thjeshtë, janë të vlefshme nëse në mbledhje janë të pranishëm ortakët që përfaqësojnë më shumë se 50 (pesëdhjetë) % të të gjithë kapitalit themeltar dhe asambleja do të vendosë me votën e ortakëve që përfaqësojnë më shumë se 50 (pesëdhjetë) % të kapitalit themeltar.

12.3 Vendimet e Asamblesë së Shoqërisë për të cilat kërkohet një shumicë e kualifikuar, janë të vlefshme nëse, si në mbledhjen e parë ashtu edhe në mbledhjen e dytë janë të pranishëm ortakët që përfaqësojnë paktën  $\frac{3}{4}$  e të gjithë kapitalit themeltar dhe Asambleja do të vendos si në mbledhjen e parë ashtu edhe në mbledhjen e dytëme votën e ortakëve që përfaqësojnë  $\frac{3}{4}$  e kapitalit themeltar.

Jane kompetence vetem e asamblese se shoqerise detyrat si vijone:

- Percaktimi i politikave tregetare te shoqerise
- Te ndryshojë nenet e ketij statusi
- Emerimin apo shkarkimin e administratorit
- Emerimin apo shkarkimin e auditoreve



- Percaktimin e pages apo shperbilimevete administratorit dhe audituesit
- Te ndryshojë selin e shoqerise
- Te ndryshojë emrin e shoqerise
- Rritje ose zvogelimin e kapitalit te shoqerise
- Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise
- Miratimin e rregullores se punes per mbarvajtjen e shoqerise
- Ceshtje te tjera qe kerkohen me ligj ose status

### **Neni 13 – E drejta e pjesëmarrjes së votës**

13.1 Cdo ortak katë drejtë të marr pjesë në Asamble dhe të paraqes mendimin e tij dhe të jap po aq vota sa është numri i kuotave të kapitalit që ai zotëron.

13.2 Cdo ortak katëdrejtë tē përfaqësohet nga një person tjetër jo ortak, i pajisur me prokurë me shkrim, me anën e së cilës do tē japë votën e tij.

13.3 Ortaku nuk mund tē lëshoj prokurë pér votim pér një pjesë tē kuotave të kapitalit që ai zotëron, në qoftë se voton personalisht pér pjesën e mbetur tē kuotave.

### **Neni 14 – Thirrja e Asamblesë së Ortakëve**

14.1 Asambleja e Ortakëve thirret tē paktën një herë në vit, Brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit finanziar, me qëllim miratimin e Bilancit, tē Raportit tē Administratorit, Ekspertit Kontabël si dhe Inventarit.

14.2 Asambleja mund tē thirret në cdo moment nga një prej administratorëve ose nga një ose disa ortakë që përfaqësojnë më shumë se 5 (pesë) % tē kapitalit themeltar.

14.3 Asambleja duhet tē thirret nëpërmjet njofimit me letër rekomande me kthim përgjigje që duhet t'u dërgohet ortakëve në adresën që rezulton në Librin e Ortakëve dhe Ekspertit Kontabël, nëse është emëruar një i tillë, tē paktën 7 (shtatë) dite kalendarike përpara mbledhjes së Asamblesë. Thirrja duhet tëpërbajë informacion mbi llojin e Asamblesë, si dhe çështejt që do tē trajtohen dhe pér tē cilat do tē duhet tē merret vendim, vendin, orën dhe datën e thirrjes së parë dhe tē dytë.

14.4 Asambleja mund tē thirret dhe jashtë Selisë së Shoqërisë, në Shqipëri dhe jashtë saj.

14.5 Mbledhjet e Asamblesë mund tē mbahen edhe nëpërmjet telekonferencës dhe videokonferencës, me kusht që tē gjithë pjesëmarrësit tē mund tē identifikohen dhe t'u lejohet



të ndjekin diskutimin dhe të ndërhyjnë në momentin që duhet të rezultojnë në procesverbalin e mbledhjes. Asambleja konsiderohet në vandin ku ndodhet Kryetari dhe Sekretari i mbledhjes.

14.6 Asambleja do të thirret dhe mbahet rregullisht dhe pa respektimin e formalitetave të njoftimit, në rast se janë të pranishëm ortakët që përfaqësojnë të gjithë kapitalin themeltar.

14.7 Cdo Asamble do të drejtohet nga një ortak ose ndonjë person tjetër icaktuar nga e njëjtë Asamble. Për pasqyrimin e vendimit, Asambleja emëron një sekretar, që mund të jetë edhe jo-ortak.

14.8 Vendimet e Asamblesë duhet të nënshkruhen nga Kryetari dhe Sekretari i Asamblesë.

### **Neni 15 – Administrimi**

15.1 Shoqëria administrohet nga 1 (një) administrator, i cili qëndron në detyrë deri në revokim apo dorëheqje, për një periudhë maksimale prej 5 (pesë) vjetësh, me te drejten e rinovimit.

15.2 Përfaqësimi ligjor do ti besohet administratorit Znj. Merita Mucaj lindur 22.12.1983, lindur ne Berat, banore në Tiranë, Rruga Eduard Mano, Nd2, Hyrja 23, Apartamenti 27, Farke, Selite, 1044 Tirane, shtetase Shqiptare, identifikuar me karte identiteti nr. I36222056P madhore e me zotësi të plotë Juridike për të vepruar.

Administratori do të ushtrojë të gjitha kompetencat sipas parashikimeve të nenit 95 të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Per Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare".

15.3 Administratori mund të emëroj përfaqësues të posaçëm për akte të vecanta ose kategori aktesh.

### **Neni 16 – Eksperti Kontabel i Autorizuar**

16.1 Në rast se kërkohet nga ligji apo vendoset nga Asambleja e ortakëve, kontrolli i Pasqyrave Financiare dhe Librave Kontabël të Shoqërisë mund t'i besohet një eksperti kontabël të licensuar.

16.2 Eksperti Kontabel i licensuar mund të shkarkohet sipas mënyrës së parashikuar nga legjislacioni në fuqi.



**KREU IV**  
**VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPERNDARJA E FITIMEVE**

**Neni 17**

17.1 Viti Financiar fillon me datë 1 Janar dhe mbaron në datë 31 Dhjetor të secilit vit kalendarik.

17.2 Viti i parë financiar fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar dhe përfundon më 31 Dhjetor të të njëjtë vit kalendarik.

17.3 Bilancet vjetore, Raportet e administratorit dhe ekspertit kontabel të autorizuar, nëseështë emëruar, miratohen nga Asambleja e Ortakëve me shumicën e përcaktuar sipas ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 “ PërTregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare”.

17.4 Miratimi i dokumenteve që lidhen me Vitin Financiar duhet të bëhet Brenda 6 (gjashtë) muajve nga fundi i Vitis Financiar.

**Neni 18 – Fitimet**

18.1 Fitimet që rezultojnë nga Bilanci vjetor, duke zbritur 5 (pesë) % të destinuara për rezervën ligjore deri në 10 (dhjetë) % të kapitalit themeltar, dhe duke zbritur gjithashtu të gjitha shumat që Asambleja vendos të lërë mënjanë, u shpërndahen ortakëve në proporcion me kuotat e kapitalit themeltar të zotëruara, pasi eshte paguar dividenti.

18.2 Asambleja mund të vendos dhe zbritje të veçanta në favor të rezervave të jashtëzakonshme ose për qëllime të tjera apo për shtyrjen e shpërndarjes së fitimeve, plotësisht ose pjesërisht, për vitet financiare të ardhshme.

**KREU V**  
**SHPERNDARJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE**

**Neni 19 – Prishja**

19.1 Shoqëria prishet me Vendim të Asamblesë së Ortakëve, me shumicën e kërkuar për ndryshimet në Statut.

19.2 Shoqëria nuk prishet në rast të humbjes së zotësisë për të vepruar, pazotësisë juridike, vdekjes ose falimentit të njërit ose disa ortakëve.



## **Neni 20 – Likujdimi**

20.1 Në rast prishje, Shoqëria duhet të likujdohet.

20.2 Për të administruar këtë proces, Asambleja emëron një ose më shumë Likuidatorë, të cilët paraqesin raportet përfundimtare, mbi gjendjen e Aktiveve dhe Pasiveve të Shoqërisë, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohën e nevojshme për përfundimin e likuidimit.

20.3 Me përfundimin e procedurës së likuidimit, Asambleja do të vendos mbi Bilancin Financiar përfundimtar, mbi punën e kryer nga Likuiduesi dhe mbi përfundimin e procesit të likuidimit.

20.4 Pas pagimit të kreditoreve dhe mbledhjes së kredive, likuidatori do të shpërndaj të ardhurat përfundimtare të likuidimit oratkëve në proporcione kuotat e kapitalit themeltar të zotëruara prej tyre.

## **Neni 21 – Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

21.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij statuti, si dhe ato që mund të lindin në perjithësi midis ortakëve (përveç atyre personale dhe jashtë Shoqërisë) ose midis një apo më shumë ortakëve të Shoqërisë, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtëpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.

21.2 Në rast se nuk arrihet një zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjes, ato do ti besohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

## **Neni 22 – Gjuha**

22.1 Ky Statut është përbërë nga 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe me vlerë të njëjtë ligjore.

Lexuar, gjetur konform vullnetit të lirë e të pavarur, pranuar dhe nënshkruar nga ortakët themelues.

### **ORTAKËT THEMELUES**

### **MERITA MUÇAJ**

